



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AAB Construction shpk” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “AAB Construction shpk” të datës 07.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “AAB Construction shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 07.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativ dhe hapësirave gjelbëruese në rrugën Muharrem Fejza” me nr. të prokurimit 616-25-1686-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.07.2025



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.